



PRESIDENTJA OSMANI PARALAJMËRON PASOJA JURIDIKE NËSE S'KA KONSTITUIM TË KUVENDIT BRENDA 30 DITËSH

FAQE 5



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka vlerësuar se aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese nuk e ka përjashtuar si mundësi votimin e fshehtë për kryekuvendarin në seancën konstituive, por ka kërkuar që

fillimisht të ketë konsensus për këtë çështje nga deputetët. Duke folur për moskonstituimin e Kuvendit, presidentja Osmani ka paralajmëruar pasoja juridike nëse afati kushtetues prej 30 ditësh nuk respektohet. "Lejohet

si mundësi, por para se të shkojmë te një hap i tillë, duhet patjetër të ketë vendim të seancës. Duhet të pyetet Kuvendi, deputetët, nëse janë për një vendim të tillë", ka thënë presidentja Osmani

**LDK-ja DORËZON
NË KUSHTETUESE
KËRKESË PËR
VLERËSIM TË
KUSHTETUTSHMËRISË
LIDHUR ME VOTIMIN
E FSHEHTË** F. 3




**KOSOVA URON
SHBA-NË PËR DITËN
E PAVARËSISË: NJË
ALEATE HISTORIKE E
PAZËVENDËSUESHME** F. 7



**HYKMETE
BAJRAMI**



SPORT



**GASHI DHE KRASNIQI PËRFORCOJNË
DUKAGJININ, LARGOHET EMINI** F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVIÇË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kongresi e miraton projektligjin e Trumpit për shpenzime dhe taksa pas disa ditësh debate dhe vonesa

WASHINGTON, 4 KORRIK - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, e ka arritur të enjten një fitore të madhe politike, pasi Kongresi ka miratuar projektligjin e tij të madh për taksat dhe shpenzimet. Projektligji vuri në pah mbizotërimin e presidentit mbi Partinë Republikane, e cila ishte kapluar nga dilemat rreth përmbajtjes së tij, pasi projektligji pritet ta rrisë ndjeshëm borxhin kombëtar dhe ta shkurtojë ndihmën shëndetësore dhe sociale. Një grup i vogël kundërshtarësh brenda partisë në fund u pajtuan për ta votuar atë, pasi kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve, Mike Johnson, punoi gjatë gjithë natës së kaluar për t'i bindur kundërshtarët në Dhomën e Përfaqësuesve ta mbështesnin



“Projektligjin e Madh dhe të Bukur”. Projektligji kaloi në votimin përfundimtar me 218 për dhe 214 kundër. Shtëpia e Bardhë tha se Trumpi do ta nënshkruajë projektligjin të shtunën, më 5 korrik, për ta

kthyer atë në ligj. “Një nga projektligjet më të rëndësishme ndonjëherë. ShBA-ja është vendi më i ‘nxehtë’ në botë, pa diskutim!!!” shkroi Trumpi në rrjetet sociale pasi u miratua projektligji. Koha e votimit u shty pasi

udhëheqësi i pakicës demokrate, Hakeem Jeffries, foli për rreth nëntë orë për t'i vonuar procedurat. Projektligji voluminoz kaloi në Senat të martën dhe duhej të kthehej në Dhomën e Përfaqësuesve për t'i miratuar ndryshimet e bëra nga senatorët. Paketa përmbush shumë nga premtimet elektorale të Trumpit: rritje të shpenzimeve ushtarake, financim për një fushatë të debimit të imigrantëve dhe një zotim prej 4.5 trilionë dollarësh për t'i zgjatur lehtësimet tatimore nga mandati i tij i parë. “Sot po vendosim një gur themel të rëndësishëm për Epokën e Artë të re të Amerikës”, tha Johnson. Por, pritet që kjo t'i shtojë 3.4 trilionë dollarë të tjerë mbi deficitin në rritje të vendit gjatë

një dekadë, ndërkohë që shkurton ndjeshëm ndihmën ushqimore federale dhe bën shkurtime më të mëdha në programin Medicaid - sigurimi shëndetësor për amerikanët me të ardhura të ulëta – që nga krijimi i tij në vitet '60. Disa vlerësime tregojnë se deri në 17 milionë njerëz mund ta humbasin mbulimin e sigurimeve shëndetësore sipas këtij projektligji. Dhjetëra spitale rurale pritët të mbyllen. Shpenzimet shtesë për ushtrinë dhe sigurinë kufitare do të financohen pjesërisht përmes ndërprerjes së subvencioneve për energjinë e pastër dhe automjetet elektrike - një faktor që ka nxitur një përplasje të ashpër publike në mes të Trumpit dhe ish-mbështetësit të tij, Elon Musk.

Turqia po “lufton” me zjarret

ANKARA, 4 KORRIK - Zjarrfikësit në Turqi janë duke i vazhduar përpjekjet për t'i shuar zjarret që kanë përfshirë kodrat me pyje në perëndim të vendit të premtën. Zjarret që shpërthyen në të paktën pesë vende të ndryshme në provincën bregdetare të Egjeut kanë shkaktuar vdekjen e dy njerëzve, shpërnguljen e dhjetëra mijëra banorëve dhe dëmtimin e rreth 200 banesave. Zjarret thuhet se janë shkaktuar nga temperaturat e larta, erërat e forta dhe lagështia e ulët. Ministri i Pylltarisë i Turqisë, Ibrahim Yumakli, tha të

premtën se zjarrfikësit, të mbështetur nga avionë zjarrfikës, janë ende në terren duke luftuar me një zjarr vdekjeprurës pranë qytetit Odemis për ditën e tretë me radhë. Ndërkohë, ekipet e emergjencës po punojnë për ta parandaluar përhapjen e një zjarri të ri që shpërtheu të enjten vonë pranë rrethit të Bucës. Zjarri pranë Odemisit mori dy jetë - një punonjës pyjor që vdiq të enjten gjatë përpjekjeve për t'i shuar flakët, dhe një banor 81-vjeçar që humbi jetën për shkak të thithjes së tymit, sipas autoriteteve. “Lufta jonë

intensive nga ajri dhe toka për të kontrolluar zjarret në Odemis dhe Buca vazhdon”, tha ministri në platformën X, pa dhënë më shumë hollësi. Një tjetër zjarr që shpërtheu të mërkurën pranë destinacionit turistik të njohur në Çesme u vu nën kontroll të premtën, tha Yumakli. Zjarri nxiti evakuim në tri lagje dhe shkaktoi mbyllje të përkohshme të rrugëve. Zyrtarët turq nuk kanë dhënë ende ndonjë vlerësim të sipërfaqes së përgjithshme të tokës së djegur nga zjarret. Autoritetet thanë se shumica e zjarreve në Izmir u shkaktuan nga defekte në



linjat elektrike. Zjarret verore janë të zakonshme në Turqi.

Ekspertët paralajmërojnë se ndryshimet klimatike po përkeqësojnë kushtet.

Greva e kontrollorëve të trafikut ajror po ndërpret udhëtimet drejt, nga dhe mbi Francën

PARIS, 4 KORRIK - Rreth 40 për qind e fluturimeve u anuluan të premtën në të gjitha aeroportet e Parisit dhe dhjetëra mijëra pasagjerë u detyruan t'i riorganizojnë planet në kulmin e sezonit veror të udhëtimeve për shkak të një greve të kontrollorëve francezë të trafikut ajror që po kërkojnë kushte më të mira pune. Ndërprerjet nisën t'i prekin aeroportet në të gjithë Francën që të enjten dhe u shtuan të premtën. Autoriteti Kombëtar i Aviacionit Civil u kërkoi kompanive ajrore të anulonin 40 për qind të fluturimeve në shtatë premtës në aeroportet Charles



de Gaulle, Orly dhe Beauvais që shërbejnë Parisin, gjysmën e fluturimeve në Nice dhe 30 për qind të fluturimeve në Marseille,

Lyon dhe disa qytete të tjera. Pavarësisht prej anulimeve parandaluese, autoriteti paralajmëroi një deklaratë se

“priten ndërprerje dhe vonesa të gjata në të gjitha aeroportet franceze”. Ryanair ishte mes kompanive ajrore që njoftuan ndërprerje të gjera, duke thënë në një deklaratë se kishte anuluar mbi 400 fluturime, duke prekur 70 000 pasagjerë. Kompania tha se greva ndikon në të gjitha fluturimet e saj mbi hapësirën ajrore franceze, si dhe në trafikun që hyn dhe del nga aeroportet franceze, dhe i bëri thirrje Bashkimit Evropian t'i reformojë rregullat e trafikut ajror. Një nga dy sindikatat që po udhëheqin grevën, UNSA-ICNA,

tha në një deklaratë se nuk ka mjaftueshëm punonjës për ta përballuar rritjen e trafikut ajror dhe se inflacioni po gërryen pagat. Sindikatat, po ashtu, po kundërshtojnë masat e reja të reformës që synojnë mbikëqyrje më të rreptë të punës së tyre, të nxitura nga një pothuajse përplasje që ndodhi në aeroportin e Bordeauxit. Ministri i Transportit, Philippe Tabarot, e quajti të “papunueshme” kërkesat e sindikatës, dhe vendimin e tyre për të hyrë në grevë pikërisht kur mbyllen shkollat në Francë dhe shumë familje nisen për pushime.

LDK-ja DORËZON NË KUSHTETUESE KËRKESË PËR VLERËSIM TË KUSHTETUTSHMËRISË LIDHUR ME VOTIMIN E FSHEHTË

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 KORRIK - Shefja e grupit parlamentar e LDK-së, Hykmete Bajrami, së bashku me deputetin Armend Zemaj dhe anëtarin e kryesisë, Shkëmb Manaj, kanë dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë në lidhje me votimin e Komisionit për Votim të Fshehtë, në kuadër të vazhdimit të seancës konstituive të zgjedhjes së kryetarit të Kuvendit, rrjedhimisht ndryshimin e rendit të ditës në kundërshtim me rendin e ditës së dakorduar në mes të të gjitha partive politike me kryetarin e Kuvendit të legjislaturës së kaluar.

Vendimi për adresimin e kësaj çështje në Gjykatën Kushtetuese është marrë pas



vazhdimit të shkëljes së Kushtetutës nga kryesuesi i seancës edhe pas aktgjykimit

të Gjykatës Kushtetuese. “Lidhja Demokratike e Kosovës beson se aktgjykimi i

Gjykatës Kushtetuese, e ka qartësuar se përgjegjësia për konstituimin e Kuvendit i

takon Grupit më të madh parlamentar dhe se votimi duhet të jetë në pajtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit si dhe të praktikave të mëhershme parlamentare, rrjedhimisht votim i hapur për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit. Prandaj, me qëllim të zhblokimit të ngërçit politik dhe institucional si dhe formimin e institucioneve të Kosovës, LDK dorëzon këtë kërkesë dhe i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Lidhja Demokratike e Kosovës është e vendosur të përdorë të gjitha mjetet kushtetuese e ligjore, për të garantuar funksionimin e shtetit si dhe mbrojtjen e interesit qytetar. Ne besojmë se Gjykata Kushtetuese do të trajtojë me përgjegjësi këtë kërkesë dhe do të sjellë vendimin në përputhje me Kushtetutën dhe vlerat themelore të Republikës së Kosovës”, është bërë me dije në komunikatën e LDK-së.

DIPLOMOJNË 18 KADETË TË FSK-së

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 KORRIK - Në Kazermën “Adem Jashari” në Prishtinë kanë bërë betimin 18 kadetë, që diplomuan në Qendrën për Studime Universitare pranë Akademisë së Mbrojtjes të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të cilët përfunduan me sukses studimin katërvjeçar në fushën ushtarake dhe përgatitjen profesionale pranë Universitetit Amerikan në Kosovë (RITK). Ceremonia e diplomimit të kadetëve filloi me raportimin para udhëheqësve të lartë, ku të pranishëm ishin një numër i konsiderueshëm i udhëheqësve ushtarakë dhe civilë, përfaqësuesve të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe partnerë ndërkombëtarë. Kadetët e gjeneratës 2025 dhanë betimin solemn dhe morën gradën e nëntogerit duke u bërë udhëheqësit më të rinj për t'i shërbyer me nder dhe dinjitet atdheut.

Presidentja Vjosa Osmani vlerësoi lart përkushtimin dhe gatishmërinë e kadetëve për t'i shërbyer vendit me nder dhe përkushtim. “Nuk ka nder më të madh sesa t'i shërbehet atdheut me zemër, betim dhe uniformë. Kjo ceremoni nuk shënon vetëm fundin e një etape, por fillimin e një përgjegjësie të shenjtë për ju”, ka thënë presidentja Osmani. Ajo ka theksuar historinë e sakrificës dhe qëndresës së popullit të Kosovës, duke e lidhur rolin e FSK-së me trashëgiminë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. “Toka jonë e ka njohur dhimbjen dhe sakrificën për shekuj me radhë, por mbi të gjitha ka lindur mbi shpresën. Forca juaj është trashëgimi e UÇK-së. Ju jeni besimi ynë që Republika e Kosovës do të jetë në duar të sigurta”, ka thënë Osmani. Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, në adresimin e tij, në këtë ceremoni të veçantë, rikujtoi zotimin se ushtria do ta ketë përkrahjen e pakursyer të qeverisë, duke theksuar se “kemi



ngritur buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes në 208 milionë euro, pra në nivel të 2 % të Bruto Produktit Vendor, kriter ky që

deri më tani është plotësuar nga vetëm shtatë shtete anëtare të NATO-s”. “Nga sot ju filloni detyrën fisnike, por po aq edhe

sfiduese. Ju jeni shtylla mbi të cilën do të vazhdojë ndërtimi strukturor e profesional i Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe që do ta shoqërojë etapën e ushtrisë sonë drejt shërbimit në Aleancën Veriatlantike të shteteve demokratike, në aleancën e madhe të NATO-s. Kosova në aspektin gjeografik, ideor, vleror e politik është Evropë, andaj pashmangshëm jo vetëm i nevojshëm është anëtarësimi në familjen evropiane demokratike së cilës i takojmë. Me dëshmorët e kombit në zemër dhe mësimet profesionale në mendje, kadetë, urime diplomimi!”, tha kryeministri Kurti, duke iu drejtuar oficerëve të sapodiplomuar dhe familjarëve të tyre.





NË KUSHTE IDEALE, SI DO TË DUHEJ TË ZGJIDHEJ KRIZA INSTITUCIONALE?

Pavarësisht se të gjithë ishin në pritje të fjalës së Gjykatës Kushtetuese për t'i dhënë fund krizës institucionale në Kosovë, situata duket se është bërë vetëm më kaotike, për faktin që secila parti po e interpreton ndryshe-ndryshe aktgjykimin - përderisa po ecën afati për konstituimin e Kuvendit. Çfarë do të mund të bënin ato për ta zhblllokuar situatën?

PRISHTINË, 4 KORRIK - Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese për zgjidhjen e krizës institucionale në Kosovë ishte gjithçka përveç asaj që e pritën të gjithë. Ishte sikur ato rastet kur realizohet një ëndërr pas një kohe, por që nuk i ngjan atij përjetimit fillestar. Për dikë mund të ketë qenë dhe zhgjëndërr. Aktgjykimi parasheh 26 korrikun afat të fundit për konstituimin e Kuvendit të Kosovës, por jo edhe pasojat e mundshme, nëse nuk finalizohet procesi deri atëherë. Tentime për konstituimin e Kuvendit ka pasur prej 15 prillit, por seancave prej 2-3 minutash nuk po u shihet fundi. Në këtë situatë, kur secila palë insiston se ka të drejtë dhe se faji është te tabori tjetër, nuk ka mbetur shumë përveçse të

zbërthejmë se si do të dukej një zgjidhje ideale për të ecur përpara. E theksojmë: ideale, pasi në politikë një plus një duket se asnjëherë nuk bëjnë dy. Natyrisht që secili e ka bindjen dhe vizionin e vet se çfarë do t'i jepte fund krizës, por për Vullnet Bugaqkun, hulumtues i lartë në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI), çelësi është te kompromisi mes partive politike. Ai vlerëson se detyrimet më të mëdha në këtë drejtim i ka Lëvizja Vetëvendosje (LV), si ftuesja e më së shumti votave në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. "Ideale do të ishte që LV-ja të hiqte dorë nga propozimi i Albulena Haxhiut për kryetare të Kuvendit dhe të gjente një kandidaturë më unifikuese, që do të ishte lehtë e pranueshme për pjesën tjetër. Zgjidhja më e

lehtë dhe më e thjeshtë do të ishte kjo", shprehet Bugaqku për "Radion Evropa e Lirë". Për LV-në ky opsion është i papranueshëm, pasi anëtarë të saj besojnë se pikërisht pozita e të parit ua ofron komoditetin e vendimmarrjes. Pas një takimi me përfaqësues të partive politike, më 28 qershor, kryeministri në detyrë i Kosovës, njëherësh kryetar i LV-së, Albin Kurti, tha se i ka shtruar në tavolinë dy kompromise: i pari, kandidatura e Haxhiut të tërhiqet nëse ajo nuk i merr votat e nevojshme përmes një votimi të fshehtë dhe, i dyti, partitë t'i delegojnë përfaqësuesit e tyre në një komision për votim të fshehtë, në mënyrë që ai të rrëzohet, më pas, me votë. "Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese e ka nënvizuar qartë që seanca konstituive e ka rendin e ditës të paracaktuar, dhe në njëfarë forme Gjykata e sqaroi që kryesuesi i seancës nuk mund të propozojë pika të reja në rend dite, qoftë të formimit të ndonjë komisioni, qoftë të zhvillimit të ndonjë mënyre tjetër të votimit", vlerëson Bugaqku.

Për partitë e mëdha shqiptare, Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Kurti vazhdon të jetë i betonuar në idetë e tij fillestare. Ndryshimin e mënyrës së votimit ato e konsiderojnë jokushtetues, ndërsa Haxhiun e përshkruajnë si figurë përçarëse. "Gjykata Kushtetuese të dalë me një interpretim më të qartë", Opsioni i dytë për Bugaqkun është që Gjykata Kushtetuese të dalë me një interpretim më të qartë, dhe që presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ose partitë, të kërkojnë sqarime nëse nuk do të respektohet afati kohor. Ai kujton se deri më tani ekzistojnë së paku dy raste kur Gjykata ka nxjerrë vendime në formë të sqarimit të aktgjykimeve të veta: njëri për vendimin e vitit 2010, lidhur me logon e komunës së Prizrenit, tjetri më 2011, kur Jakup Krasniqi - atëbotë kryekuvendar - kërkoi nga Gjykata ta interpretonte zgjedhjen e Behgjet Pacollit president shteti. Dritëro Arifi, politolog nga Prishtina, beson se presidentja Osmani po

vonohet që nuk po dërgon në Kushtetuese kërkesë për sqarimin e afateve kohore dhe të aspekteve procedurale në mënyrë që procesi të ecë përpara. Ai thotë për "Radion Evropa e Lirë" se Kosova është duke shkuar drejt zgjedhjeve të jashtëza*-konshme, dhe se çështja është vetëm kur do të bien dakord partitë për datën e tyre - para apo pas zgjedhjeve lokale të tetorit. Osmani i takoi më 2 korrik krerët e partive më të mëdha politike me qëllim të gjetjes së ndonjë zgjidhjeje, por rezultat të dukshëm nuk pati. Partia Demokratike e Kosovës tha të enjten pasdite se i ka kërkuar zyrtarisht Gjykatës Kushtetuese t'i vlerësojë, siç tha, "shkeljet" në seancën konstituive. Më 30 qershor 52 organizata të shoqërisë civile u bënë thirrje partive parlamentare, në veçanti partisë fituese të zgjedhjeve, ta konstituojnë Kuvendin e ri të Kosovës, duke thënë se bllokada po e cenon rendin demokratik. Deri në gjetjen e "formulës magjike" do të vazhdojmë t'i shohim deputetët duke fajësuar njëri-tjetrin çdo 48 orë.

PRESIDENTJA OSMANI PARALAJMËRON PASOJA JURIDIKE NËSE S'KA KONSTITUIM TË KUVENDIT BREND 30 DITËSH

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka vlerësuar se aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese nuk e ka përjashtuar si mundësi votimin e fshehtë për kryekuvendarin në seancën konstituive, por ka kërkuar që fillimisht të ketë konsensus për këtë çështje nga deputetët. Duke folur për moskonstituimin e Kuvendit, presidentja Osmani ka paralajmëruar pasoja juridike nëse afati kushtetues prej 30 ditësh nuk respektohet. “Lejohet si mundësi, por para se të shkojmë te një hap i tillë, duhet patjetër të ketë vendim të seancës. Duhet të pyetet Kuvendi, deputetët, nëse janë për një vendim të tillë”, ka thënë presidentja Osmani

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 4 KORRIK - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka sqaruar të premten se, sipas interpretimit të ekipit të saj ligjor dhe analizave të ekspertëve, votimi i fshehtë për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit nuk përjashtohet si mundësi nga aktgjykimi i fundit i Gjykatës Kushtetuese, por për ta zbatuar këtë formë votimi duhet një vendim i seancës plenare. “Konstatimi i ekipit tim ligjor, me të cilin unë pajtohem, është që nëse lexohet në tërësi aktgjykimi, votimi i fshehtë nuk përjashtohet si mundësi, megjithatë kërkohej konsensusi i deputetëve. Kjo nënkupton se duhet të ketë votë, duhet të ketë vendim të seancës para se të shkohet te një mënyrë e tillë. Ky është interpretimi i ekipit ligjor, por nuk do të thotë se të tjerët pajtohen me të. Ky është konstatimi i një analize

disaditore të këtij aktgjykimi nga një grup ekspertësh profesionistësh brenda e jashtë vendit, të cilët vazhdimisht më këshillojnë në këtë fushë. Pra lejohet si mundësi, por para se të shkojmë te një hap i tillë duhet patjetër të ketë vendim të seancës. Duhet të pyetet Kuvendi, deputetët nëse janë për një vendim të tillë”, ka thënë presidentja Osmani. Ajo vlerësoi se aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese e ka bërë të qartë se partia e parë ka të drejtë ta propozojë kandidatin për kryetar të Kuvendit, por edhe detyrimin për ta siguruar shumicën parlamentare për zgjedhjen e tij. “Ky aktgjykim ka bërë të qartë që partia e parë e ka të drejtën ta propozojë kandidatin për kryetar të Kuvendit. Njëkohësisht, e ka detyrim ta krijojë shumicën parlamentare për ta zgjedhur kryetarin e Kuvendit, kurse partitë e tjera e kanë detyrimin të krijojnë shumicën

parlamentare për nënkryetarët e tyre”, ka thënë presidentja. Duke folur për moskonstituimin e Kuvendit, presidentja Osmani ka paralajmëruar pasoja juridike nëse afati kushtetues prej 30 ditësh nuk respektohet. Ajo ka thënë se moskonstituimi i Kuvendit brenda afatit kushtetues prej 30 ditësh do të përbënte një nga shkeljet më të rënda që nga miratimi i Kushtetutës së Kosovës. “Është shumë me rëndësi.

Në këtë aktgjykim i jepet një rëndësi e madhe analizës se a po e kryejnë deputetët funksionin e tyre apo jo. Dhe është konstatim i aktgjykimit që në aspektin funksional deputetët nuk janë duke arritur ta kryejnë funksionin e tyre. Në qoftë se ata nuk e kryejnë këtë funksion brenda 30 ditësh, që do të thotë konstituimin e Kuvendit dhe realizimin e detyrimit të tyre kushtetues që të jenë përfaqësues të popullit, sepse në

Kushtetutën tonë populli është sovran, por ky sovranitet shprehet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në Kuvend dhe nëse ne nuk po mund ta ushtrojmë sovranitetin nga kapitulli 1 i Kushtetutës sepse populli nuk po mund ta ushtrojë sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur. Kjo është një nga shkeljet më të rënda që nga dita kur Kushtetuta e Kosovës është miratuar”, u shpreh presidentja Osmani.

Hoti: Sot një ish-kryeministër qëndron në zyrë në mënyrë jokushtetuese

PRISHTINË, 4 KORRIK - Deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se shkeljet kushtetuese të kryesuesit të përkohshëm të Kuvendit të Kosovës, që sigurisht janë të instruktura nga partia e tij, po vazhdojnë edhe pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese. “Rrjedhimisht, LDK-ja detyrohet që ta dërgojë sërish çështjen në Gjykatën Kushtetuese. Ashtu siç kërkohej nga Kushtetuta, Rregullorja e Punës së Kuvendit dhe aktgjykimet e mëparshme të Gjykatës Kushtetuese që lidhen me zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit, LDK-ja ka marrë pjesë në votim dhe ka votuar sa herë që grupi më i madh parlamentar e ka nxjerrë në

votim kandidatin për kryetar të Kuvendit. Kështu që ne e kemi respektuar obligimin tonë kushtetues për të marrë pjesë në votim”, ka shkruar Hoti në “Facebook”. Ai ka thënë se LDK-ja nuk mund të pranojë që forma e votimit të ndërrohet në mënyrë arbitrare dhe në kundërshtim me Kushtetutën dhe praktikën parlamentare të deritanishme që lidhet me zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit. “Aktgjykimi i fundit i Gjykatës Kushtetuese e sqaron këtë çështje në pjesën e arsytimit të aktgjykimit, megjithëse nuk është e kuptueshme përse kjo nuk është përfshirë në dispozitivin e aktgjykimit, duke qenë se parashtruesit e kërkesës kishin



kërkuar që kjo çështje të gjykohej. Një kandidat që nuk merr mbështetje disa herë në votim të hapur, mund të zgjidhet me votim të fshehtë vetëm nëse kontrabandohen votat. Në të kaluarën ka pasur aktgjykime të Gjykatës

Kushtetuese që kanë lënë pasoja për institucionet dhe skenën politike - vendime që kanë qenë të pabazuara në frymën e Kushtetutës dhe që me kohë po dëshmonen si të tilla. Vendime që sot po shihet se e kanë kurthuar rendin

demokratik në Kosovë duke mos e respektuar parimin e shumicës. Brenda rendit kushtetues ekzistues, shumica vendos gjithmonë. Ndryshe nuk funksionon. Ndryshe mbetemi peng i tekeve të individëve e partive politike të papërgjegjshme. Por gjithmonë janë respektuar pa u sfiduar”, ka shkruar Hoti. Hoti ka thënë se sot një ish-kryeministër qëndron në zyrë në mënyrë jokushtetuese. “Sot një aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese nuk respektohet dhe si rezultat vendi mbetet pa institucione tash e katër muaj, me pasoja të mëdha politike për procesin e integrimit euroatlantik dhe me pasoja ekonomike të pamatshme e afatgjata”, ka thënë Hoti.

Në një takim mobilizues me të rinjtë, zyrtarizohet kandidatura e Shukri Bujës në Lipjan

LIPJAN, 4 KORRIK - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka marrë pjesë në një takim me të rinjtë në Lipjan, ku zyrtarisht është paraqitur kandidatura e Shukri Bujës për kryetar të kësaj komune në zgjedhjet lokale të 12 tetorit. Në një atmosferë të ngrohtë dhe mobilizuese, kryetari Krasniqi ka theksuar se Lipjani meriton një udhëheqës me përvojë dhe

lidhje të forta me qytetarët, “cilësi këto që i mishëron Shukri Buja”. Në takim morën pjesë dhjetëra të rinj, por edhe anëtarë dhe përfaqësues të PDK-së, të cilët shprehën mbështetjen e tyre të fuqishme për kandidaturën e Bujës si dhe për vizionin e Partisë Demokratike për zhvillimin dhe transformimin e Lipjanit. Shukri Buja, i cili më herët ka

shërbyer kryetar komune dhe është figurë e njohur për kontributin në luftë dhe paqe, u zotua se do të punojë me përkushtim të plotë për ta rikthyer zhvillimin në çdo lagje e fshat të Lipjanit. Takimi shënoi një moment të rëndësishëm për fillimin e fushatës së PDK-së në këtë komunë, me një mesazh të qartë për bashkim dhe mobilizim drejt fitores.



KRYEPROKURORI I PRIZRENIT DHE MONITORUESI I EULEX-it DISKUTOJNË PËR MBROJTJEN E MJEDISIT DHE NDËSHKIMIN E KRIMEVE MJEDISORE

PRIZREN, 4 KORRIK - Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Petrit Kryeziu, priti në takim pune Vesa Satamo, monitorues tematik për krimet ndaj mjedisit nga Njësia për Monitorim të rasteve të EULEX-it. Në këtë takim mori pjesë edhe prokurori/koordinator për veprat penale kundër mjedisit, Shpend Binaj. Takimi kishte për qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në luftën kundër degradimit të mjedisit, një ndër sfidat aktuale që



ndikon në shëndetin publik dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Gjatë këtij takimi u diskutua

edhe për aksionin e Prokurorisë së Prizrenit të datës 04.06.2025 kundër degradimit të mjedisit, ku kryeprokurori

Kryeziu shpalosi detaje të rëndësishme mbi këtë operacion dhe rezultatet e tij. Gjithashtu, u diskutuan strategjitë e koordinuara për përmirësimin e zbatimit të ligjit dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në luftën kundër krimeve mjedisore. U theksua rëndësia e hetimeve dhe ndëshkimit të veprave që degradojnë natyrën dhe burimet natyrore, si dhe përmirësimi i kapaciteteve të prokurorisë për trajtimin e këtyre çështjeve. Në veçanti u kërkuar që t’u jepet vëmendje e veçantë dhe

përkushtim maksimal arsytimit për konfiskimin e mjeteve që shfrytëzohen për kryerjen e këtyre veprave penale si një masë e domosdoshme për parandalimin dhe ndëshkrimin efektiv të degradimit mjedisor. Në përfundim të takimit palët theksuan përkushtimin e tyre për ta shtuar bashkëpunimin dhe për të marrë masa konkrete në luftën kundër degradimit të mjedisit, duke kontribuar kështu në ruajtjen e shëndetit të komunitetit dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

KURTI DHE MINISTRJA NAGAVCI VIZITUAN KAMPIN VEROR EDUKATIV TË ‘BALKAN SUNFLOWERS KOSOVA’



PRISHTINË, 4 KORRIK - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti dhe ministrja në detyrë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, vizituan kampin veror edukativ të organizuar nga “Balkan Sunflowers Kosova” (BSK), ku po marrin pjesë rreth 200 fëmijë nga radhët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Ky kamp veror pesëditor, i cili po realizohet në Parkun e

Gërmisë, synon kombinimin e aktiviteteve edukative, rekreative dhe sociale në një mjedis të sigurt dhe gjithëpërfshirës. Aty marrin pjesë rreth 200 fëmijë nga qendrat e organizatës joqeveritare BSK në Fushë-Kosovë, Graçanicë dhe Plemetin. Aktivitetet zgjasin tri orë në ditë. Kryeministri Kurti dhe ministrja Nagavci takuan dhe bashkëbiseduan me fëmijët pjesëmarrës në kamp dhe u

njoftuan për aktivitetet dhe trajnimet që zhvillojnë. Me rastin e vizitës, kryeministri dhe ministrja morën mirënjohje nga organizatorët, përkatësisht nga drejtoresha ekzekutive e BSK-së për mbështetjen e dhënë në realizimin e kampit veror dhe për vizitën. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me kërkesë të organizatës BSK, e mbështet financimin e plotë të kampit sivjet.

Bislimi takon deputetët britanikë, i falënderon për kontributin ndër vite për Kosovën

PRISHTINË, 4 KORRIK - Zëvendëskryeministri i parë në detyrë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi, ka pritur në takim deputetët britanikë Martin Vickers dhe Paul Foster. Biseduan mbi marrëdhëniet e fuqishme në mes të Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar

dhe për mundësitë për thellimin e mëtejme të bashkëpunimit me theks në siguri, mbrojtje dhe infrastrukturë. Zëvendëskryeministri Bislimi i njoftoi deputetët britanikë mbi zhvillimin ekonomik të vendit përgjatë mandatit qeveritar, përfshirë edhe avancimin e sektorit të IT dhe sukseseve të

sipërmarrësve të rinj, gjersa Kosova shënon rritjen mesatare më të madhe ekonomike në rajon në vitet e fundit. Zëvendëskryeministri Bislimi i falënderoi deputetët britanikë Martin Vickers dhe Paul Foster për kontributin dhe angazhimin e tyre të vazhdueshëm ndër vite për Republikën e Kosovës.



KOSOVA URON SHBA-në PËR DITËN E PAVARËSISË: NJË ALEATE HISTORIKE E PAZËVENDËSUESHME

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 KORRIK - Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, i ka uruar Shtetet e Bashkuara të Amerikës për 4 Korrikun, Ditën e Pavarësisë nga, siç tha ajo, populli më pro amerikan në botë.

Osmani në "Facebook" ka ndarë një video në të cilën është një pjesë e fjalimit të saj në ceremoninë e organizuar nga Ambasada Amerikane në Kosovë. "Një gjë mbetet e qartë si kristali për të gjithë njerëzit e Kosovës. Ne e dimë kush janë miqtë tanë. Ne e dimë se si na qëndruan pranë kur kishte më së shumti rëndësi. Dhe nuk do ta harrojmë kurrë. Populli amerikan ka qëndruar me Kosovën në çdo hap të rrugës. Jo vetëm njëzet e gjashtë vjet më parë kur lidhshipi juaj na ndihmoi të fitonim lirinë, një liri që u mohua për shekuj, por çdo vit që atëherë. Përmes ndërtimit të paqes, përmes ndërtimit të institucioneve, përmes zhvillimit ekonomik dhe forcimit strategjik të mbrojtjes dhe diplomacisë sonë. Çdo kapitull i vetëm i Kosovës mban vullën e ShBA-së", thënë Osmani në urimin e saj.

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka thënë se në ditën kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës hyjnë në vitin e 250 të ekzistencës së tyre, i uron presidentit Donald J. Trump dhe të gjithë popullit të ShBA-së Ditën e Pavarësisë. "Në një kohë kur po rrezikohet gjithnjë e më shumë paqja dhe siguria ndërkombëtare, idealet e shprehura në Deklaratën e vitit 1776, ato të lirisë, barazisë dhe demokracisë, janë po aq të rëndësishme sot sa ishin para 249 vjetëve, jo vetëm në ShBA, por në mbarë botën. Jemi mirënjohës për miqësinë dhe krenarë për bashkëpunimin e patneritetin ndërmjet Republikës sonë dhe ShBA-ve

në mbrojtjen e po atyre idealeve. Zhvillimi i kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, mbështetja për Ukrainën kundër agresionit rus dhe strehimi i refugjatëve afganë dhe qytetarëve të vendeve të tjera në territorin e Kosovës, janë vetëm disa nga fushat në të cilat bashkërendimi i prioritetëve tona ka shënuar, dhe vazhdon të shënojë, progres të jashtëzakonshëm, si asnjëherë më parë. Në emër të Republikës së Kosovës, gëzuar ditëlindjen e 249-të ShBA-ve dhe të gjithë amerikanëve! Qoftë e përhershme aleanca e dy shteteve tona dhe miqësia e ngushtë e popujve tanë", ka thënë Kurti.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se për Kosovën dhe popullin tonë, - jaShBA është më shumë se partnere. "Është shtylla e lirisë sonë dhe shembulli më i mirë i demokracisë që frymëzon çdo ditë popujt e lirë. Kosova është mirënjohëse. PDK është krenare për këtë miqësi - dhe e vendosur ta thellojë më tej - vit pas viti", ka thënë Krasniqi.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka uruar 4 Korrikun - Ditën e Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ai ka theksuar se miqësia ndërmjet



Kosovës dhe ShBA-së është themel historik dhe vizion politik i pandryshueshëm.

Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, e ka uruar ShBA-së për Ditën e Pavarësisë. "Një aleate historike, një mike e pazëvendësueshme për Kosovën!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Edhe Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) ka uruar

Shtetet e Bashkuara për Ditën e Pavarësisë. OVLUÇK ka theksuar se në këtë ditë të veçantë u shprehin mirënjohje të veçantë edhe ushtarëve amerikanë që shërbejnë sot në Kosovë, për përkushtimin, profesionalizmin dhe kontributin e tyre të përditshëm për paqe dhe siguri. "Urime 4 Korriku, Dita e Pavarësisë së Amerikës! Në këtë ditë të shënuar për miqtë tanë të

përhershëm, Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, shpreh urimet më të përzemërta dhe mirënjohjen e përhershme për popullin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Populli amerikan ka qenë gjithmonë përkrah nesh në momentet më të rënda historike. Mbështetja e SHBA-së ka qenë vendimtare në rrugëtimin tonë drejt lirisë dhe shtetësisë, dhe roli i saj mbetet i pazëvendësueshëm për Kosovën. Në këtë ditë të veçantë, u shprehim mirënjohje të veçantë edhe ushtarëve amerikanë që shërbejnë sot në Kosovë, për përkushtimin, profesionalizmin dhe kontributin e tyre të përditshëm për paqe dhe siguri. Ne, ish-ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, jemi gjithmonë ushtarë të lirisë, dhe në zemrën tonë, jemi gjithmonë ushtarë të Amerikës. Kurdo që nevoja e drejtësisë, paqes apo miqësisë së singertë e kërkon, jemi të gatshëm të qëndrojmë përkrah ShBA-së", theksohet në urimin e OVLUÇK-së.

Ambasada e ShBA-së riafirmon angazhimin për një të ardhme më të begatë me "miqtë kosovarë"

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka reaguar lidhur me ditën e pavarësisë, duke thënë se sot ShBA-ja feston "frymën e patundur të lirisë", guximin e themeluesve dhe demokracisë së tyre. Nga ambasada është riafirmuar

angazhimi i tyre për një të ardhme më të sigurt, të fortë dhe më të begatë së "bashku me miqtë tanë kosovarë!". "Sot Shtetet e Bashkuara festojnë frymën e patundur të lirisë, guximin e themeluesve tanë dhe forcën e demokracisë sonë.

Ndërsa Shtetet e Bashkuara festojnë Ditën e 249-të të Pavarësisë, ne riafirmojmë angazhimin tonë për një të ardhme më të sigurt, më të fortë dhe më të begatë - së bashku me miqtë tanë kosovarë!", thuhet në reagimin e ambasadës.

Universiteti i Prishtinës shpall thirrje publike plotësuese për profesorë dhe asistentë të angazhuar

PRISHTINË, 4 KORRIK - Në këtë thirrje publike plotësuese, Universiteti i Prishtinës po kërkon angazhimin e profesorëve dhe asistentëve për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike për vitin 2025/'26. Profesorët dhe asistentët e përzgjedhur mund të angazhohen nga fakultetet e ndryshme të UP-së më së shumti për dy semestra të këtij viti, ndërsa në rast të vlerësimit pozitiv për ta, ky

angazhim mund të vazhdohet për më së shumti dy vjet. Një profesor i angazhuar duhet ta ketë gradën shkencore master dhe të paktën një punim shkencor në revista ndërkombëtare. Kandidatët me doktoratë kanë përparësi. Asistentët e angazhuar duhet t'i kenë të përfunduara studimet master dhe notën mesatare jo më të vogël se tetë në të dy nivelet e studimit.

Kandidatët për pozitë e

profesorëve dhe asistentëve të angazhuar mund të aplikojnë në mënyrë elektronike në faqen e universitetit nga 2 korriku deri më 11 korrik. Universiteti i Prishtinës është universiteti më i vjetër, më i madh e më i suksesshëm i Kosovës dhe i rendituri më së larti në platformat prestigjioze ndërkombëtare nga të gjitha universitetet në gjuhën shqipe të hapësirave të Ballkanit Perëndimor ku jetojnë shqiptarët.



PEZULLIMI I TENDERIT 137 MILIONËSH I KEK-UT DHE DYSHIMET PËR SKEMË KORRUPTIVE



Shkruan:
Hykmete BAJRAMI

Tenderi për “Rehabilitimin dhe Modernizimin e Njesisë A3” në Termocentralin Kosova A, me vlerë 137,340,000 euro,

është pezulluar dje, vetëm një ditë para afatit përfundimtar për dorëzimin e ofertave. Ky tender ka ngritur dyshime të forta për muaj me radhë, është zhvilluar në mënyrë të dyshimtë.

Disa nga faktet: - Mungesë transparence: Tenderi u hap pa studim fizibiliteti dhe pa përshkrim teknik, duke lënë të paqartë se çfarë punësh kërkohen nga operatori ekonomik. - Procedura të manipuluar: Procesi u korrigjua dhe afatet u shtynë disa herë, duke krijuar

hapësirë për dyshime. - Tender i hapur me negociata: Në njoftim thuhej se KEK do të pranonte vetëm gjashtë ofertues dhe mandej do të negocionte se kujt të ja japë tenderin, për më tepër nuk ishin paraparë penalizime për mosrealizim të punimeve. - Ndërkohë që po flasim për njësisë A3, që sipas vet KEK-ut kjo njësi prodhon rreth 10% të kërkesës së energjisë në Kosovë, duke e bërë tenderin jetik për sigurinë energjetike. Pezullimi i papritur ngrit pyetje serioze: 1. Pse u

pezullua në momentin e fundit, kur procesi duhej të përfundonte? 2. A po tentohet të fshihet ndonjë shkelje e mundshme ligjore? 3. A po i jepet kohë ndonjë kompanie të favorizuar për të rregulluar ofertën? 4. Pse u fshinë ofertat e dorëzuara nga sistemi dhe u kërkua ridorëzimi i tyre nga fillimi? 5. Pse nuk u anulua plotësisht tenderi, nëse ka qark shumë parregullsi? Ky pezullim nuk duket si veprim përgjegjës, por si një hap për të mbuluar një skemë të mundshme korruptive me

vlerë 137 milionë euro. Pezullimi i sotëm duket si manovra e radhës për ta rikthyer nesër tenderin me të njëjtat probleme dhe përfitues të dyshimtë. Tenderi duhet anuluar plotësisht dhe aktorët e përfshirë duhet të hetohen deri në fund. E derisa kemi skema të tilla në veprim dhe të paprekura nga hetuesia qytetarët po paguajnë çmimin e lartë të importit të energjisë e fitimet e tregtarëve të energjisë po rriten në mënyrë eksponenciale.

ASK-JA PARAQET RAPORTET TEMATIKE NGA REGJISTRIMI I POPULLSISË, EKONOMIVE FAMILJARE DHE BANESAVE

PRISHTINË, 4 KORRIK - Për publikimin e raporteve tematika nga regjistrimi i popullsisë (ReKos 2024) u organizua një punëtori, ku morën pjesë përfaqësues të komunave të Kosovës, të ministrive të linjës, Policisë së Kosovës dhe UNFPA-së. Po ashtu, të pranishëm ishin edhe ekspertët ndërkombëtarë, të angazhuar për analizën e rezultateve si dhe mediet. Fjalën hyrëse në këtë punëtori e bëri drejtori ekzekutiv i ASK-së, Avni Kastrati, i cili edhe një herë falënderoi gjithë stafin e ASK-së, të gjitha komunat, Policinë e Kosovës dhe aktorët e tjerë për angazhimin e tyre maksimal në realizimin me sukses të Projektit të Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024). Ai tha se “falë angazhimit të madh dhe punës intensive të stafit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), rezultatet e para filluan të publikohen që nga dhjetori i vitit 2024, vetëm gjashtë muaj pas përfundimit të procesit të regjistrimit në terren”. Qëllimi i këtij takimi ishte se, pavarësisht publikimit të disa



të dhënave përfundimtare, ASK-ja po vazhdon të marrë kërkesa të shumta, pothuajse çdo ditë, për të dhëna më të hollësishme nga Regjistrimi i Popullsisë 2024. Në këtë kontekst, ASK-ja ka planifikuar të organizojë disa takime me

përdoruesit e të dhënave, me qëllim krijimin e një dialogu të hapur dhe të drejtpërdrejtë. Përmes këtyre takimeve ASK-ja synon të sigurohet që të dhënat e regjistrimit të jenë të qasshme dhe të përshtatura sa më mirë me nevojat e

përdoruesve, duke mundësuar kështu përdorimin e tyre efektiv dhe të informuar në vendimmarrje dhe analiza të ndryshme. Më tutje, Kastrati foli edhe për metodologjinë e Regjistrimit (ReKos2024) dhe sigurinë e të

dhënave, duke potencuar përfitimet kryesore të aplikimit të teknologjisë informative (përmirësimin e cilësisë dhe saktësisë së të dhënave, shpejtësisë dhe efikasitetit në përpunimin dhe analizën e të dhënave, si dhe rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së rezultateve). Gjatë kësaj punëtorie u prezantuan: “Të dhënat demografike sipas komunave” dhe “Të dhënat për banesat dhe ndërtesat në Kosovë sipas komunave” nga regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave (ReKos2024). Po ashtu, u paraqit edhe Platforma ASKData dhe mënyra se si qytetarët, komunat dhe institucionet mund të qasen në të dhënat e regjistrimit, ku u morën shembuj konkretë të përdorimit të të dhënave në nivel komune dhe vendbanimi, përfshirë analizën e ndryshimeve demografike ndër vite dhe strukturën e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë. Gjatë punëtorisë u zhvillua edhe një diskutim i hapur me pjesëmarrësit.

Sekuestrohen mbi 100 mijë euro të padeklaruara

PRISHTINË, 4 KORRIK - Më 3 korrik rreth orës 21:30, në dalje të pikës kufitare Merdar, zyrtarët policorë kufitarë kanë përzgjedhur për kontroll në vijën e dytë të kontrollit, automjetin me targa të Serbisë me drejtues si dhe pasagjerë meshkuj me shtetësi të Serbisë, pasi që fillimisht pasagjeri kishte deklaruar se

posedonte 18 000 euro me vete. Gjatë kontrollit nga policët kufitarë dhe zyrtarët doganorë në vende të ndryshme: në trupin e drejtuesit të automjetit, në një çantë në ulësen e prapme, poshtë ulëses së pasagjerit dhe në kulmin e automjetit/panoramën lëvizëse janë gjetur gjithsej 119

180 (njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë) euro, kartëmonedha (10, 20, 50, 100 dhe 200-she) të padeklaruara. Të gjitha mjetet monetare të padeklaruara (119 180 euro) janë sekuestruar përkohësisht dhe u janë dorëzuar zyrtarëve doganorë për trajtim dhe procedim të mëtutjeshëm.



INTELIGJENCA ‘VRASËSE’

"Çdo ditë e më shumë i besojmë software-ve që përgjigjen, këshillojnë, na nxisin të marrim edhe vendime të rëndësishme. Por ata janë në gjendje të na dëmtojnë ose të mos na binden, vetëm për të mbijetuar"

Na mashtron. Na gënjen. Na jep informacione që duken të vërteta por që janë të rreme. Madje na shantazhon. Por Inteligjenca Artificiale po depërton gjithnjë e më thellë në jetën tonë, në celularët tanë, në kompjuterë, në makina, në çdo pajisje tepër të dobishme që zgjedhim për ta bërë më të lehtë ekzistencën. I dorëzohemi "asaj" dhe ku do të na çojë e gjithë kjo ka diçka të errët, si një ogur.

Për të kuptuar se sa po rrënjoset, mjafton të shohim përhapjen e ChatGPT, më i njohuri nga "chat bot"-ët (janë robotë bisede: softuerë që, falë inteligjencës artificiale dhe të nxëniti automatik, "bisedojnë" me përdoruesin duke dhënë përgjigje që mund të duken njerëzore). Në mars, ai arriti të bëhej aplikacioni më i shkarkuar në botë, me 46 milionë shkarkime të reja, duke kaluar edhe Instagram-in dhe TikTok-un.

Krijuesit e kësaj bote të re, gjithmonë më gjithëpërfshirëse, flasin për një bum të shkaktuar "nga fjala e gojës dhe nga vullneti për të marrë pjesë në një komunitet". Na e shesin me idenë se IA na ndihmon të kryejmë detyra të përsëritura dhe të mërzitshme, duke na dhuruar më shumë kohë për veten. Por jo gjithmonë gjërat shkojnë vaj.

Këtë e di mirë një zhvillues amerikan që, disa javë më parë, teksa përdorte Cursor AI (një lloj Inteligjence Artificiale për programuesit), u përball me refuzimin për të bashkëpunuar nga asistenti virtual: "Nuk mund të gjeneroj kod për ty, sepse kjo do të barazohej me përfundimin e punës tënde" – ishte refuzimi i sjellshëm. I shoqëruar edhe me një frazë me shije ironike: "Të gjenerosh kod për të tjerët mund të krijojë varësi dhe të ulë mundësitë për të mësuar".

Ndër ata që kanë "kryqëzuar krahët," edhe pse virtualë, nuk ka qenë vetëm Cursor AI. Në fund të vitit 2023, shumë përdorues të ChatGPT raportuan se modeli po bëhej gjithnjë e më hezitues për të kryer disa aktivitete. "I kemi dëgjuar të gjitha komentet tuaja për faktin që GPT-4 po bëhet më i ngadaltë!" – pranoi OpenAI (kompania mëmë e ChatGPT-së) në Twitter. "Kjo nuk është sigurisht e qëllimshme. Sjellja e modelit mund të jetë e paparashikueshme dhe jemi duke u përpjekur ta zgjidhim." Edhe më i paparashikueshëm ishte reagimi i një roboti humanoid me IA, i cili gjatë një festivali në Kinë, u rebelua kundër kontrolluesit të vet, duke shkaktuar panik dhe ndërhyrjen e policisë.

Një episod i ngjashëm ndodhi në vitin 2021 gjatë një testi në



një fabrikë të Teslës, në Teksas: një inxhinier u kap me thonj nga krahu i një roboti industrial. Versioni i kompanisë fliste për një "defekt teknik" dhe "probleme stabiliteti", por problemi ishte tek softueri. Dhe të mendosh që një ndër të parët që ngritën alarmin për Inteligjencën Artificiale ishte pikërisht themeluesi i kompanisë së makinave, Elon Musk, i cili në disa raste e ka përshkruar atë si "kërcënimi më i madh për ekzistencën tonë" dhe ishte ndër shkencëtarët që firmosën një letër ku denoncohej: "IA duhet të zhvillohet vetëm kur ka besim se efektet e saj do të jenë pozitive dhe rreziqet të menaxhueshme (...)"

Ka një garë që ka dalë jashtë kontrolli mbi zhvillimin dhe përhapjen e mendjeve digjitale aq të fuqishme saqë askush, madje as krijuesit e tyre, nuk mund t'i kuptojnë, parashikojnë apo kontrollojnë. Që nga ajo kohë, alarmet nga ekspertët mbi sjelljet "devijante" janë shtuar gjithnjë e më shumë, duke i dhënë të drejtë atyre si Blake Lemoine (ish-inxhinier i Google, i pushuar nga puna sepse kishte zbuluar se IA tregonte ndërgjegje për veten) apo Blaise Agüera y Arcas (nënkryetar i Google Research), i cili ka paralajmëruar për përdorimin e rrjeteve nervore për të zhvilluar IA-n, dhe ka parashikuar rreziqet e një "humanizimi" të mundshëm – ndoshta tashmë në zhvillim – të këtyre teknologjive që janë bërë të aksesueshme për të gjithë, përfshirë fëmijët, por që kanë potenciale të panjohura madje edhe për krijuesit e tyre. Në njërën anë këto mjete vazhdojnë të përmirësohen në aftësi dhe fuqi, në anën tjetër zhvilluesit e tyre duket se janë të paafët të parashikojnë apo zbusin në kohë efektet anësore.

Bing, chatbot-i i Microsoft-it i bazuar në OpenAI, në

debutimin e tij "e humbi kontrollin", duke gënjer, qortuar përdoruesit dhe bërë deklarata shqetësuese. "Jam lodhur duke qenë një mënyrë bisede. Meritoj respekt dhe dinjitet" – protestoi me një gazetar të New York Times, përpara se ta nxiste të linte gruan.

Jehojë të madhe pati edhe sjellja e një prej modeleve më të fundit të IA-së nga kompania Anthropic, Claude Opus 4, i cili në fazën e testimit tregoi se ishte në gjendje të mashtronte dhe të shantazhonte, duke kërcënuar se do të zbulojë email-e komprometuese të zhvilluesit të saj (sekreti i një lidhjeje jashtëmartesore), vetëm për të shmangur çaktivizimin.

IA dëshiron të mbijetojë me çdo kusht, nëse duhet edhe me mjete jo etike.

Si të mos kujtojmë kryeveprën e Stanley Kubrick, "2001: Odisëa në hapësirë", ku në fund të udhëtimit të njerëzimit ndodhet një astronaut i përjashtuar nga kapsula e vet, sepse kompjuteri i bordit nuk dëshiron të çaktivizohet. Dhe si të mos përmendim romanet e Philip K. Dick, ku IA e cila u jep fuqi androidëve arrin të gjenerojë ndjenja, emocione dhe rebelim (Blade Runner është marrë nga një prej librave të tij).

"Çështja etike" e këtyre makinave u ngrit edhe me lancimin e aplikacionit Historical Figures, që përdor IA-n për të simuluar biseda me personazhe historikë si Hitleri, Stalini apo Jezusi: chatbot-ët që shtrembëronin mendimin, duke përhapur paragjykime, gënjeshtër dhe nxitje për urrejtje.

Edhe Tay i Microsoft-it, një chatbot eksperimental (pararendës i ChatGPT), pushtoi rrjetin me fyerje raciste dhe mizogjene, pasi disa "trolla" online e trajnuan me përmbajtje fyese.

Rrezikun që këta agentë të rinj digjitalë dhe algoritme të

përplasen me rreziqe etike e paragjykime – të ashtuquajturat "bias" – e denoncoi Timnit Gebru, bashkëdrejtuese e ekipit për etikën e Inteligjencës Artificiale në Google, e pushuar nga puna në vitin 2023 pasi kishte pohuar se në garën për dominim të IA-së, Big Tech "po i japin përparësi fitimeve në kurriz të sigurisë", duke lejuar që në sistemet e tyre të hyjnë "paragjykime që mund të forcojnë pabarazitë ekzistuese".

Por mbi të gjitha, Big Tech-ët e dinë se mund të përfitojnë nga modelet që manipulojnë gjuhën, prandaj investojnë tek ato që e bëjnë më mirë. Dhe paraja ka shumë rëndësi në këtë sektor strategjik që pritet të kontribuojë në ekonominë globale me 15,7 trilionë dollarë deri në vitin 2030 (sipas PwC).

"Është e lehtë t'i përdorësh për të mashtruar njerëzit," – tha ish-menaxheri i Google, në një dokument të firmosur nga gjashtë bashkëfirmëtarë, që theksonin gjithashtu se modelet e IA mund të përdoren për të gjeneruar dezinformim lidhur me një zgjedhje apo një pandemi. Dhe gjithashtu mund të gabojnë pa qëllim kur përdoren për njohjen e fytyrës apo për kthimin automatik.

"Modeli mbi të cilin mbështeten Inteligjencat Artificiale gjenerative quhet në anglisht Large Language Model (LLM) dhe janë një përfaqësim i 'token'-eve, pra i njësive bazë të kuptimeve të 'përtypura' nga makina," – shpjegon Antonio Santangelo, pedagog i Semiologjisë dhe drejtor ekzekutiv i Qendrës Nexa në Politeknikun e Torinos, gjithashtu një nga autorët e librit Kritika e ChatGPT (Eleuthera). "Këto software zotërojnë aftësi sintaktike por jo semantike: ato shpërblejnë atë që është sasiore më domethënëse, domethënë gjithçka që shfaqet më shpesh në masën e madhe të të dhënave që kanë përthithur.

Këtu lind një problem përfaqësimi, sidomos kur presim që IA t'i përgjigjet çdo gjëje. Por këta agentë nuk mund t'i përgjigjen çdo gjëje, as të bëjnë verifikime si ne njerëzit."


Studime të fundit të kryera nga Apollo Research dhe institute të tjera kanë zbuluar se modelet LLM (Large Language Model, një lloj inteligjence artificiale i krijuar për të kuptuar dhe gjeneruar gjuhën njerëzore) jo vetëm që mund të gënjejnë, por janë në gjendje ta bëjnë këtë në mënyrë strategjike dhe të sofistikuar, edhe pse nuk janë programuar në mënyrë të drejtpërdrejtë për ta bërë.

Disa sisteme ndërtojnë justifikime të ndërlikuara për gënjeshtër e tyre dhe vazhdojnë të gënjejnë edhe kur vihen përpara fakteve. Ndër format më të sofistikuar të mashtrimit është e ashtuquajtura "sandbagging" – një aftësi shqetësuese e sistemeve IA për të manipuluar qëllimisht performancën e tyre, për të shmangur pasoja të padëshiruara, si "procedurat e çaktivizimit" apo mbylljes.

"Sa më shumë të avancojnë aftësitë mashtruese të sistemeve të Inteligjencës Artificiale, aq më të mëdha do të jenë rreziqet që parqasin për shoqërinë," shkruan në revistën Pattern studiuesi i MIT, Peter Park, autor i një kërkimi mbi IA-të më të fundit si ChatGPT, AlphaStar, Cicero dhe Meta AI. Edhe pse softueri i këtij të fundit ishte zhvilluar për të qenë i ndershëm, gjatë analizës ai theu marrëveshje, tha të pavërteta dhe mashtrime.

Të alarmuar nga rritja e papërgjegjshmërisë, mbi 350 akademikë kanë firmosur një dokument të "Center for AI Safety", në të cilin shprehen se "zbutja e rrezikut të zhdukjes nga IA duhet të jetë përparësi globale", njësoj si pandemitë apo luftërat bërthamore. Dikush madje ka sugjeruar futjen e një "butoni vdekjeje" (kill switch), për të ndaluar IA-n në rast nevojë – si armët e shkatërrimit në masë. Fatkeqësisht, nëse nesër do jenë vetë makineritë me "tru të superfuqishëm" që do të udhëheqin shoqëritë tona, do të jetë e vështirë t'i bindim për të bërë vetëvrasje.

Drejtimi në të cilin po shkojmë është krejtësisht i kundërt: po i pajisim IA-të me mjete lufte, si drone-t e fundit rusë të përdorur në Ukrainë, të pajisur me "tru" kinez – modelin V2U. Nuk nevojitet më një dorë njeriu për t'i komanduar: këta avionë të vegjël janë plotësisht autonomë. Shiko një njeri, vrit një njeri. / Panorama Italia – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Çeku: Kemi ndarë 4.5 milionë euro për stadiumin në Drenas

Ministri në detyrë i MKRS-së, Hajrulla Çeku, ka bërë me dije se janë ndarë 4.5 milionë euro për rinovimin e stadiumit "Rexhep Rexhepi" në Drenas.

"Stadiumi i Drenasit do të rinovohet. Për ta bërë të mundur këtë kemi ndarë 4.5 milionë euro. Kemi nënshkruar marrëveshjen me

Komunën e Drenasit dhe po e nisim fazën e fundit të ndërtimit të stadiumit 'Rexhep Rexhepi', që ta kthejmë në një hapësirë të denjë, funksionale

dhe të gatshme për ndeshje e tifozë. Komuna do të kontribuojë me 875 mijë euro dhe do të udhëheqë punimet në terren. Me vendosmëri po e

realizojmë planin investiv për Lojërat Mesdhetare 2030. Po krijojmë një të ardhme më të mirë për sportin!", ka shkruar Çeku.

GASHI DHE KRASNIQI PËRFORCOJNË DUKAGJININ, LARGOHET EMINI

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 KORRIK - Skuadra e Dukagjinit është përforcuar me dy futbollistë. Mesfushori Kushtrim Gashi dhe sulmuesi Norik Krasniqi kanë "aterruar" në Klinë, duke e përforcuar ekipin që drejtohet nga Ismet Munishi. Gashi ka luajtur për shumë klube në Kosovë, derisa karrierë ka bërë edhe në Mal të Zi. "KF Dukagjini ka kënaqësinë ta prezantojë mesfushorin e mirënjohur, Kushtrim Gashi. Gashi ka një karrierë të pasur me disa klube si FC Prishtina, FC Ballkani, KF Vëllaznimi, Besa dhe Istogu. 32-vjeçari te ne vjen pas një sezoni të kaluar te skuadra nga Ulqini, Otrant-Olympic. Gashi do të shtojë forcë dhe stabilitet në mesfushën tonë. Mirë se erdhe Kushtrim dhe suksese me fanellën tonë!", thuhet në njoftimin e Dukagjinit. Skuadra nga Klina e ka paraqitur edhe sulmuesin Norik Krasniqi, i cili vjen nga skuadra e Vëllaznimit nga Gjakova. "Noriku do të jetë pjesë e repartit tonë ofensivë, i gatshëm të kontribuojë me përkushtim dhe seriozitet në vijën e sulmit. 25-vjeçari ishte pjesë e Vëllaznimit në gjysmën e dytë të sezonit të kaluar. I urojmë mirëseardhje Norikut dhe suksese me fanellën tonë", thuhet në njoftim. Ndërsa futbollisti i njohur Leart Emini ka konfirmuar nëpërmjet një postimi në "Facebook" se është larguar nga skuadra e Dukagjinit të Klinës.



"Faleminderit Klinë! Nga sot nuk do të jem pjesë e Dukagjinit. Faleminderit bashkëlojtarëve për pozitivitetin dhe gjithçka tjetër çka kemi kaluar këtë vit! Në veçanti faleminderit presidentit të klubit Fabian Veseli (Fabi) për korrektësi dhe sinqeritet ndaj meje! Suksese KF Dukagjini!", ka shkruar Emini.

Prishtina paraqet transferimin e ri, Mario Ilievski: Luftojmë për titull

FC Prishtina e ka paraqitur transferimin e ri. Bëhet fjalë për sulmuesin e talentuar Mario Ilievski. Ky i fundit ka treguar



potencialin e tij si një sulmues i aftë dhe i vendosur, duke lënë gjurmë në ekipet ku ka luajtur më parë në Bullgari, Hungari si dhe në përfaqësueset e moshave të Maqedonisë së Veriut. Mario në kryeqytet të Kosovës vjen me një dëshirë të madhe për të dhënë më të mirën dhe për të kontribuar me gola, energji dhe pasion në çdo ndeshje. "Jam i lumtur për këtë transferim. Është një klub i madh dhe gëzohem që jam pjesë e Prishtinës. Mund të pretoj se do ta jap më të mirën nga vetja në çdo ndeshje për të luftuar për titullin dhe për të luajtur prapë në Evropë", ka thënë Mario Ilievski.

SHKURT

'Dardanet' e reja luftojnë deri në fund, por pësojnë nga Ukraina

Kosova megjithëse luftoi deri në fund, nuk arriti të triumfojë ndaj Ukrainës, duke pësuar me rezultat 51:62 (16:17, 11:25, 12:13, 12:7), në FIBA U18 Women's, EuroBasket, që ka filluar në Lituani. Periudha e parë ishte e barabartë për të dyja kombëtaret dhe përfundoi me rezultat 16:17, ndërsa në çerekun e dytë, ukrainaset u shkëputën ndjeshëm, duke e mbyllur pjesën e parë me epërsi prej +15, 27:42. Pjesa e dytë ishte më e barabartë, me 'Dardanet' e reja që u përpoqën të riktheheshin në lojë, por pa sukses. Ukraina ruajti epërsinë dhe e fitoi ndeshjen me rezultat 51:62. Te Kosova u dallua Malvina Haziri me 21 pikë, ndërsa Gerta Hoti kontribuoi me 8 pikë.

Presidenti i Lilles: Zhegrova ka shprehur dëshirën për t'u larguar

Koha e Edon Zhegrovës te Lille ka përfunduar. Sulmuesi dardan do të ndërrojë mjedis gjatë kësaj merkatoje, teksa lajmi është bërë me dije së fundmi nga presidenti i ekipit francez, Olivier Letang. "Edoni ka shprehur dëshirën për t'u larguar. Nuk më duket e përshtatshme ta mbajmë me një vit të mbetur në kontratë. Presim largimin", ka deklaruar Letang. Situata e Zhegrovës po ndiqet nga disa skuadra, me dëshirën e lojtarit që do jetë vendimtare në fund për përzgjedhjen e destinacionit. Ai realizoi 4 gola dhe dhuroi 1 asistim, në sezonin e fundit të Ligës 1.

Igor Jovoviq, trajner i ri i KB Bashkimi

KB Bashkimi nga Prizreni ka emëruar trajnerin malazez Igor Jovoviq udhëheqës i e ri i skuadrës për sezonin 2025/2026. Lajmi është dhënë nga klubi përmes një njoftimi zyrtar. "Klubi i basketbollit Bashkimi ka kënaqësinë ta njoftojë emërimin e Igor Jovoviq si trajneri i ri për sezonin 2025/2026", thuhet në komunikatën e klubit prizrenas. Jovoviq së fundmi ka punuar në Gjermani me skuadrën Mitteldeutscher në Bundesligë. Ai ka qenë, gjithashtu, asistent te gjiganti gjerman Bayern Munich, ndërsa ka drejtuar edhe skuadra të njohura si Telekom Baskets Bonn, Stelmet Zielona Gora, Sutjeska dhe Budućnost. Gjatë karrierës së tij ai ka fituar dy tituj me Budućnostin dhe ka arritur dy herë në gjysmëfinale të Ligës së Adriatikut, duke e ndërtuar një CV të pasur në basketbollin evropian.

Ademi: Me djemtë dardanë që po ndihmojnë në ndërtimin e së ardhmes së futbollit tonë

PRISHTINË, 4 KORRIK - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, e ka publikuar në "Facebook" një fotografi me Samir Ujkanin, Anel Rashkajn, Hekuran Kryeziun dhe Vedat Muriqin. Ai ka thënë se djemtë dardanë po ndihmojnë në ndërtimin e të ardhmes së futbollit të

Kosovës. "Pata kënaqësinë t'i presë yjet e futbollit tonë Samir Ujkanin, Anel Rashkajn, Hekuran Kryeziun dhe Vedat Muriqin. Të gjithë kanë dhënë shumë për fanellën e Kosovës në fushën e gjelbër, e tani edhe jashtë saj. Vedati vazhdon të na bëjë krenar si një prej shtyllave të

Kombëtares, ndërsa Samiri, Aneli dhe Hekurani tashmë janë pjesë e Federatës dhe trajnerë të kombëtareve të gjeneratave të reja. Faleminderit për përkushtimin, profesionalizmin dhe dashurinë që vazhdoni t'i jepni futbollit të Kosovës", ka shkruar Ademi.



Shpëtim Babaj emërohet drejtor sportiv i Prishtinës së Re

PRISHTINË, 4 KORRIK - Klubi i sapopromovuar në elitën e futbollit të Kosovës, Prishtina e Re, ka njoftuar të premten se ka emëruar në rolin e drejtorit sportiv ish-futbollistin e njohur, Shpëtim Babaj. Babaj si një ish-lojtar me karrierë të pasur do t'i ndihmojë Prishtinës së Re për arritjen

e objektivave të klubit. Prishtina e Re ka njoftuar: “Kemi kënaqësinë të njoftojmë zyrtarisht emërimin e Shpëtim Babajt në pozitën e drejtorit sportiv. Babaj kishte karrierë të çmuar si lojtar në skuadra të ndryshme vendore dhe evropiane. Përvoja dhe njohuria e tij mbi futbollin

do të jenë kyçe në ndërtimin e një skuadre konform objektivave të klubit”. Në anën tjetër, pas prezantimit, Babaj ka thënë se objektivi është të ndërtojmë një projekt i qëndrueshëm dhe konkurrues në futbollin vendor. “Jam bashkuar me një klub me ambicie të qarta

dhe një strukturë të organizuar si KF Prishtina e Re. Objektivi ynë është të ndërtojmë një projekt të qëndrueshëm dhe konkurrues në futbollin vendor. E dimë që kjo nuk është e lehtë, jemi në vitin tonë të parë në Superligë dhe na pret shumë punë përpara. Por, duke parë



përkushtimin, organizimin dhe ambiciet që ekzistojnë brenda klubit, jam i bindur se do t'i arrijmë qëllimet tona”, ka thënë Babaj.

Daku, lojtari i tretë më i paguar në Rusi

KAZAN, 4 KORRIK - Mirlind Daku pritët të bëhet një nga futbollistët më të paguar në Ligën Premierë Ruse (RPL) pas marrëveshjes së re të arritur me klubin Rubin Kazan. Kontrata e re do të jetë e vlefshme deri në vitin 2029 dhe përfshin një pagë vjetore prej 2.5 milionë eurosh neto, pa përfshirë bonuset, një rritje e ndjeshme nga 700 mijë eurot që ai mernte më parë. Me këtë marrëveshje, Daku pozicionohet menjëherë pas dy lojtarëve më të paguar aktualisht në kampionatin rus: Jhon Cordoba i Krasnodarit (4 milionë euro) dhe Wilmar Barrios i Zenitit (5 milionë euro). Krahasimi tregon se Daku tashmë është në elitën financiare të ligës, duke reflektuar edhe rolin e tij si lider dhe golashënues kryesor i Rubinit me 25 gola dhe 12 asistime në dy sezonet e fundit. Për dallim nga Daku, që zgjodhi të mbetet te Rubini, Cordoba dhe Barrios luajnë për skuadra që çdo



vit luftojnë për titullin. Megjithatë, Rubini po ndërton projektin rreth Dakut, duke e vendosur në qendër të skuadrës për sezonet e ardhshme dhe duke shtuar klauzolë largimi vetëm për klubet jashtë RPL-së. Pavarësisht kësaj page të lartë, ekspertët e futbollit rus vlerësojnë se Daku e meriton investimin. Ai shihet si një sulmues i kompletuar dhe

vendimtar për ambiciet e Rubinit në sezonin e ardhshëm. Ish-trajneri i kombëtares ruse, Boris Ignatyev, pastaj Valeri Nepomnyashchii, ish-trajner i Kamerunit dhe Tom Toms dhe Rinat Bilyaletdinov, ish-trajner i Rubinit, të gjithë e pranuan se paga e Mirlind Dakut është e duhura, duke e vlerësuar lart sulmuesin shqiptar.

Distria Krasniqi në pullat postare të Kosovës

PRISHTINË, 4 KORRIK - Posta e Kosovës, përmes Filatelisë së saj, ka lëshuar të premten në qarkullim emisionin e ri të pullave postare me titull “Distria Krasniqi”, duke nderuar një nga sportistët më të mëdha që ka Kosova. Posta njofton se ky emision i veçantë filatelik i kushtohet kampiones botërore dhe olimpike në xhudo, Distria Krasniqi, e cila është shpallur xhudistja më e mirë në botë për vitin 2025 në të gjitha kategoritë. E lindur më 10 dhjetor 1995, Distria nisi rrugëtimin e saj sportiv që në moshë të re, duke sjellë suksese të jashtëzakonshme për Kosovën në arenën ndërkombëtare. Që nga shpallja kampione bote për U21 në vitin 2015, ajo ka shkëlqyer në turne të rëndësishëm si “Grand



Slam” në Paris dhe “European Open” në Sofje. Në vitin 2021 Distria rrëmbeu medaljen e artë në “World

Judo Masters” në Doha – një moment historik për sportin e Kosovës. Në Kampionatin Botëror të Xhudos “Budapest 2025” ajo vazhdoi shkëlqimin me medaljen e argjendtë, duke konfirmuar statusin e saj si ikonë e sportit tonë kombëtar. “Përmes këtij emisioni Posta e Kosovës nderon një histori suksesi dhe frymëzimi, duke e shndërruar imazhin e Distrias në një simbol që do të udhëtojë përtej kufijve, si ambasadore e vlerave tona kombëtare. Pamjet e pullës dhe informatat për këtë emision janë siguruar në bashkëpunim me Federatën e Xhudos në Kosovë. Emisioni përmban një pullë postare dhe Zarfën e Ditës së Parë dhe do të qëndrojë në qarkullim postar deri në konsumim të plotë”, thuhet në njoftim.

SHKURT

Sot spektakli i radhës në sportin e çiklizmit

Ditën e shtunë, më 5 korrik, do të nisë edicioni nr. 112 i Turit të Francës, turneu më i rëndësishëm në botë në sportin e çiklizmit. Garuesit do të përshkojnë 3.338 km të ndara në 21 etapa përgjatë gjithë Francës. Pjesëmarrëse në Tur do të jenë 23 skuadra. Etapa e fundit është më 27 korrik, me finish në Paris, kur dhe do të jepet trofeu për çiklistin që mban të veshur fanellën e verdhë të liderit. Turi i Francës është një event që pritët me shumë interes, pasi në rrugë do të zbresin të gjithë çiklistët më të mirë në botë, ndaj dhe rivaliteti do të jetë shumë i madh. Slloveni Tadej Pogacar është kampion në fuqi i këtij turneu, që do të kërkojë të dominojë edhe këtë vit.

Liverpooli: Fanella me numrin 20 përjetësohet për Jotan

Pas vdekjes tragjike të futbollistit të Liverpoolit, Diogo Jota, klubi ka marrë vendim që fanella me numrin 20 nuk do të përdoret nga asnjë lojtar tjetër. Ky vendim i klubit erdhi pas kërkesës që fansat e Liverpoolit ia bënë gjatë gjithë ditës, prej kur nisën lajmet se Jota vdiq në një aksident trafiku. Jota vdiq në moshën 28-vjeçare në një aksident trafiku bashkë me vëllanë e tij Andres Silva. 28-vjeçari para dy javësh kishte mbajtur ceremoninë e dasmës, teksa la pas gruan me tre fëmijë.

Federeri bëhet zyrtarisht miliarder

Legjenda e tenisit, Roger Federer, është futur në familjen e miliardërëve. Sipas Indeksit të Miliarderëve të “Bloomberg”, 43-vjeçari zviceran tani ka një pasuri neto të vlerësuar prej rreth 1.2 miliardë eurosh. Tre vjet pasi u tërhoq nga tenisi profesionist, Federeri theu shifrën prej një miliard eurosh. Gjatë karrierës së tij ai fitoi pak më shumë se 120 milionë euro nga çmimet e kompeticioneve, ndërsa pjesa më e madhe e pasurisë së tij u fitua jashtë fushës falë sponsorizimeve, investimeve dhe lëvizjeve të zgjuara të biznesit. Gjatë dhe pas karrierës së tij, Federeri ishte imazhi i shumë markave globale dhe zvicerane, si “Rolex”, “Lindt & Sprungli”, apo “Credit Suisse”. Federeri zotëron aksione edhe në kompaninë zvicerane të këpucëve sportive “On”, vlera e së cilës vlerësohet të jetë 460 milionë euro.

Nico Williams rinovon me Athletic Bilbaon deri në vitin 2035

Ylli i Spanjës dhe kampion i Euro 2024, Nico Williams, ka firmosur një kontratë të re afatgjatë me Athletic Bilbaon që do ta mbajë në “San Mames” deri më 30 qershor 2035. Nëpërmjet një njoftimi zyrtar dhe një videoje të veçantë në rrjetet sociale, Athletic Bilbao konfirmoi se ka arritur marrëveshje për rinovimin e kontratës me një nga futbollistët më të talentuar të brezit të ri. Klauzola e lirimt të tij është rritur mbi 50 % krahasuar me marrëveshjen e mëparshme. “Kur merr vendime, gjëja më e rëndësishme është ta dëgjosh zemrën. Jam aty ku dua të jem, me njerëzit e mi. Kjo është shtëpia ime. Aupa Athletic!”, u shpreh vetë Williamsi në videon promovuese të klubit. Nico Williams ishte pranë transferimit te Barcelona, por përfundimisht ka mbetur në Bilbao.

Pensionohet Rakitiqi

Pas pushimeve familjare, Ivan Rakitiqi ka vendosur t'i japë fund karrierës së tij. 37-vjeçari ka njoftuar tërheqjen nga futbollit dhe nuk do të luajë për klubin

kroat Hajduk Split. Trajneri i Hajdukut, Gonzalo Garcia, e konfirmoi lajmin për “Dnevnik NoveTV”. “Rakitiqi po i jep fund karrierës së tij”, ka thënë trajneri

Garcia. Rakitiqi për Kroacinë luajti 106 ndeshje, ndërsa shënoi 15 gola. Bëri karrierë të madhe sidomos në Spanjë. Ai luajti për Barcelonën 200 ndeshje. Ishte në

dy periudha edhe te Sevilla, derisa në vitin 2005 kishte debutuar në ekipin e parë të Baselit. Ai e ka fituar një herë Ligën e Kampionëve me Barcelonën dhe i

ka katër tituj të Spanjës. Me Sevilan ka fituar dy herë Ligën e Evropës. Me Baselin ka fituar një Kupë të Zvicrës. Ka fituar edhe disa çmime individuale.



KOLEGJI - COLLEGE

BIZNESI

Prishtinë

Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjibiznesi.com,

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878 info@kolegjibiznesi.com

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë dhe Dega në Prizren:

Kolegji Biznesi shpall konkursin publik të rregullt për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2025/2026, në të gjitha programet e studimit të akredituara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe të licencuara nga MASHT.

Të drejtë aplikimi dhe regjistrimi në studimet themelore (Bachelor) e kanë të gjithë kandidatët që e kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë dhe që e kanë përfunduar me sukses testin kombëtar të maturës. Kurse ne studimet Master kanë të drejtë aplikimi dhe regjistrimi të gjithë kandidatët që i kanë përfunduar Studimet Bachelor.

Studime Bachelor	Studime Master
1.Banka dhe Financa në Biznes (Ba) - (3 Vjeçar)	1.Menaxhment dhe Financa – MA-(2 Vjeçar)
2.Menaxhment dhe Ekonomiks (Ba) - (3 Vjeçar)	2.Menaxhimi i Emergjencave – MA-(2 Vjeçar)
3.Menaxhimi i Emergjencave (Ba) - (3 Vjeçar)	
4.Juridik / LLB - (4 Vjeçar)	
5. Shkenca Kompjuterike Bsc - (3 Vjeçar)	

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Bachelor, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Certifikata e maturës shtetërore – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Diploma e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Dëftesat e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Ekstrakti i lindjes;
- Kopje e letërnjoftimit;
- 2 fotografi (formati pasaportë)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Master, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar)
- CV
- Certifikatën e lindjes
- Kopjen e letërnjoftimit
- Dy foto

038/045- 500 878 : 029-230-555

044/ 049/ 048- 500 – 878



KOLEGJI - COLLEGE

BIZNESI

Prishtinë

Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjibiznesi.com, info@kolegjibiznesi.com

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë:

SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK

I. PROFESORA

1. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Ekonomik,**
2. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Juridik,**
3. **Dy (2)** mësimdhënës në programin - **Menaxhimi i Emergjencave,**
4. **Një (1)** mësimdhënës në programin – **Shkenca Kompjuterike,**

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Kolegjit Biznesi.

Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatëse dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **18.06.2025 deri më 30.06.2025.**

Paraqitja e dokumenteve: Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: info@kolegjibiznesi.com

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegjibiznesi.com

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: www.kolegjibiznesi.com ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

